



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6-a) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/21 dhe 74/24), nenin 65-ç, paragrafi (1) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21) dhe nenin 16, paragrafi (1), pika 6) dhe nenin 17, paragrafi (1), pika 1 e Ligjit të Stabilitetit Financiar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 173/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për ndryshimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit e lartësisë së shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 136/24)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit e lartësisë së shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit të ekspozimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 26/17 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/21 dhe 149/21), në pikën 11) dhe pikën 14), paragrafi (3), nënparagrafi (1), fjalët: Këshilli i Bankës Popullore, zëvendësohen me fjalët: Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-23460/4
26 qershor 2024
Скопје

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска